

VENDIM
Nr. 329, datë 20.4.2016

**PËR DISA NDRYSHIME NË VENDIMIN NR. 997, DATË 10.12.2010, TË KËSHILLIT
TË MINISTRAVE, “PËR TRAJTIMIN FINANCIAR TË PUNONJËSVE QË
DËRGOHEN ME SHËRBIM JASHTË QENDRËS SË PUNËS, BRENDA VENDIT”,
TË NDRYSHUAR**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës, të nenit 16, të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 10, të ligjit nr. 160/2014, “Për buxhetin e vitit 2015”, me propozimin e ministrit të Financave, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

Krerët I dhe III, të vendimit nr. 997, datë 10.12.2010, të Këshillit të Ministrave, të ndryshuar, ndryshohen, si më poshtë vijon:

“I. Punonjësit e njësive të qeverisjes së përgjithshme, të cilët gjatë ditëve zyrtare të punës shkojnë me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit, trajtohen financiarisht për përballimin e shpenzimeve të shërbimit. Përfshihen, për punonjësit operacionalë të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA), të Shërbimit Informativ Shtetëror, të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, të njësive mamografike të lëvizshme, pranë Institutit të Shëndetit Publik, të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, kur marrin pjesë në shërbime operacionale specifike, të institucioneve që kryejnë inspektime, kontrole apo verifikime në subjektet private, si dhe të institucioneve, të cilët kanë detyrë funksionale kontrollin e situatave epidemike, në funksion të ruajtjes së sigurisë kombëtare, dërgimi me shërbim jashtë qendrës së punës nuk kufizohet në ditët zyrtare të punës.

....

III. Trajtimi financiar i punonjësve për përballimin e shpenzimeve të shërbimit bëhet i diferencuar, sipas distancës së shërbimit nga qendra e punës, si më poshtë vijon:

1. Për shërbime në një largësi deri në 50 km jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin vetëm shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni.

Përfshihen nga ky rregull:

a) punonjësit e Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës së Shqipërisë, të Shërbimit për Çështjet e Brendshme dhe Ankesat (SHÇBA) dhe të Shërbimit Informativ të Shtetit dhe të Agjencisë së Inteligjencës dhe Sigurisë së Mbrojtjes, kur marrin pjesë në shërbime operacionale;

b) punonjësit e Qendrës së Shërbimit Mjekësor (klinika qeveritare), kur shoqërojnë personalitete të larta të vendit;

c) anëtarët e Kolegjit Zgjedhor, kur ushtrojnë veprimtarinë pranë këtij kolegj, gjatë periudhës së zgjedhjeve parlamentare apo vendore;

ç) personeli ushtarak i Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë, i cili angazhohet në procesin e eliminimit të kimikateve stoqe në strukturat e këtyre forcave, si dhe kur merr pjesë në shërbime operacionale specifike.

Këta punonjës trajtohen sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij vendimi.

2. Për shërbime në një largësi mbi 50 km jashtë qendrës së punës, kur punonjësi kthehet brenda ditës, trajtimi financiar i tij përfshin dietën ditore, në masën 500 (pesëqind) lekë në ditë, si dhe shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni. Përfshihen nga ky rregull punonjësit që dërgohen për shërbime në një largësi mbi 50 km, jashtë qendrës së punës, dhe që zgjatin mbi tri ditë pune, në bazë të programit të miratuar nga titullari apo zyrtari përgjegjës që autorizon shërbimin, sipas legjislacionit të posaçëm në fuqi.

Këta punonjës trajtohen sipas përcaktimeve të pikës 3, të këtij vendimi.

3. Për shërbime në një largësi mbi 100 km, jashtë qendrës së punës, trajtimi financiar i punonjësit përfshin:

a) dietën ditore, e cila për çdo punonjës të dërguar me shërbim, llogaritet në masën, si më poshtë vijon:

- i) 1 000 (një mijë) lekë në ditë, kur punonjësi kthehet brenda ditës;
- ii) 10 për qind të pagës mujore, por jo më shumë se 2 500 (dy mijë e pesëqind) lekë në ditë, kur shërbimi zgjat më shumë se një ditë.

Për efekt të llogaritjes së dietës, në këtë rast, data e nisjes dhe ajo e kthimit llogariten një ditë e plotë.

b) shpenzimet e fjetjes, kundrejt dokumentit tatimor përkatës, të paraqitur nga hoteli dhe të shoqëruar me faturën e printuar nga kasa elektronike fiskale, por jo më shumë se 3 000 (tre mijë) lekë për çdo natë;

c) shpenzimet e transportit, në rastin kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni.

4. Në çdo rast, kur transporti nuk realizohet nga vetë institucioni, shpenzimet e transportit do të njihen kundrejt dokumentit tatimor përkatës, por jo më shumë se tarifa përkatëse, sipas distancës kilometrike të linjës, e miratuar në vendimin nr. 146, datë 26.2.1998, të Këshillit të Ministrave, “Për tarifat e transportit të udhëtarëve”, të ndryshuar.”.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Edi Rama